



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS
DHE ENERGJISË**

Nr. 9560/prot.

Tiranë, më 31.07.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1619, datë 03.04.2013.

**SHOQËRISË “ALFA - 7” SHPK
Lagjia SMT, Fushë Krujë**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Alfa – 7” sh.p.k. është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1619 datë 03.04.2013 për mineral Gips Alabastër, në objektin “Zbuje”, njësia administrative Helmes, Kavajë, Qarku Tiranë.

Me shkresën tuaj nr.26 datë 23.02.2016, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.1482 datë 23.02.2016 keni bërë kërkesë për revokim të lejes nr.1619 datë 03.04.2013, ku jepni shkaqet pse kërkonit të revokoni këtë leje.

Kërkesën tuaj për revokim leje e dërguam në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) si strukturë përgjegjëse për trajtimin e saj, në zbatim të kompetencave që i jep neni 43 i ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën nr.6335 datë 19.07.2016, ka bashkëlidhur Vendimin e Këshillit Teknik të saj nr.482 datë 11.07.2016: “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e planit të mbylljes dhe rehabilitimin e karrierës për gips alabastër në Zbuje, Kavajë”, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.4799 datë 20.07.2016, ku propozon miratimin e planit të mbylljes të lejes së shfrytëzimit nr.1619 datë 03.04.2013 për mineral Gips Alabastër, në objektin “Zbuje”, njësia administrative Helmes, Kavajë, Qarku Tiranë. Në këtë vendim cilësohej që ishte për tu paguar shuma 131 361 lekë, për rehabilitimin e mjedisit, si diferencë e shumës që nevojitet për rehabilitimin përfundimtar mjedisor të objektit dhe asaj të paguar.

Kërkesa juaj për revokim të lejes nr.1619 datë 03.04.2013, që nga AKBN-ja gjendet e arsyetuar, është e bërë në përputhje me pikën nr.2 të nenit 47 nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Procedurat e revokimit të lejes nuk vazhduan, sepse nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, u rihap çështja e procedimit penal kundër shoqërisë tuaj, për dëmtim banesash të

banorëve, që kanë shtëpitë në afërsi të zonës, nga përdorimi i lëndëve plasëse, në zonën për të cilën ju zotëroni lejen nr.1619 datë 03.04.2013.

Pasi është kryer riekspertimi teknik nga një grup ekspertësh, kjo çështje është mbyllur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, në favor të shoqërisë “Alfa – 7” sh.p.k., për mungesë provash, për të cilën prokuroria ka njoftuar shoqërinë e paditur me shkresën nr.2299 prot.(G.Ç), datë 04.06.2018 “Dërgohet kopja e kërkesës për pushimin e procedimit penal, kopje të cilën e keni vënë në dispozicion me shkresën tuaj datë 02.07.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.9560 datë 05.07.2018. Bashkëlidhur me këtë shkresë keni edhe mandat pagesën lëshuar nga Raiffeisen Bank datë 16.03.2018, të shumës së lekëve të paguara për rehabilitimin e mjedisit, si diferencë e shumës që nevojitet për mbylljen e aktivitetit mineral dhe asaj të paguar, siç përcaktohet në vendimin e këshillit teknik të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1619 datë 03.04.2013 për mineral Gips Alabastër, në objektin “Zbuje”, njësia administrative Helmes, Kavajë, Qarku Tiranë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1619 datë 03.04.2013 për mineral Gips Alabastër, në objektin “Zbuje”, Njësia administrative Helmes, Kavajë, Qarku Tiranë.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet mineral.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

